



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE METODOLOGJISË SË MËSIMDHËNIES

MIRATOHET
REKTOR

Prof. dr. Bektash MEMA



PROJEKT - RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT 2-VJEÇAR
ME KARAKTER PROFESIONAL PAS ARSIMIT TË MESËM

"EDUKATORE PËR ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN E FËMIJËRISË SË
HERSHME"(0-3vjeç)

Përgjegjës i Departamenti

Dr.Doc. Mimoza ÇARKA

DEKANI

Prof. dr. Gëzim SALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

KËRKESË PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

**EMEËRTIMI I PLOTË I PROGRAMIT TË STUDIMIT 2-VJEÇAR ME
KARAKTER PROFESIONAL "EDUKATORE PËR ZHVILLIMIN DHE
EDUKIMIN E FËMIJËRISË SË HERSHME"**

Institucioni i arsimit të lartë: Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë

Viti akademik: 2018-2020

Data e kërkesës: 28.02.2018

I. INFORMACION MBI INSTITUCIONIN

Të dhënat për aktet themelore	Lloji i aktit (VKM/Urdhër)	Nr.	Datë
Licensimi i institucionit			
Leja për fillimin e veprimtarisë	Hapja e ILP Hapja e UGJ	VKM Nr. 4 VKM Nr. 414	08.01.1971 12.11.1991
Akreditimi I institucionit	Vendimi i Bordit të Akreditimit	Nr. 67	21.09.2017
Hapja e njësisë	Fakulteti i Përgatitjes së Mësuesve të Arsimit Ciklit të Ulët Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore Katedër e Pedagogjisë dhe Psikologjisë në 1991 Fakultet i Edukimit me dy seksione: Seksioni i Pedagogjisë	Nr. 417 Nr. 823	03.12.1991 05.12.2007 1981-1991 1991-2007



	dhe Psikologjisë dhe Seksioni i Arsimit Parashkollor		2007-e në vazhdim
	Departament i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies		

II. INFORMACIONI MBI PROGRAMIN E STUDIMIT

II.1. Të dhëna të përgjithshme:

Emërimi i programit të studimit:	Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional “Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme” (0-3 vjeç)
Cikli i studimeve:	
Lloji i programit:	Program i studimit 2-vjeçar me karakter profesional pas arsimit të mesëm
Kodi i programit:	EZHEFH- A
Totali i Krediteve (ECTS):	120 ECTS
Kohëzgjatja normale në vite:	2 vite akademik, 4 semestra, 60 javë mësimore
Forma e studimit :	Me kohë të plotë
Gjuha e studimit:	Shqip
Vendi i njësisë bazë dhe kryesore për hapjen e programit të studimit. (Numri i vendimit dhe Data)	Vendim datë 05.02.2018 Vendim Nr. 2, datë 03.05. 2018
Vendimi i senatit Akademik për hapjen e programit të studimit. (Numri i vendimit dhe data)	Vendimi Nr. 7, datë 07. 05.2018 Vendim Nr. 10, datë 14.05.2018

II.2. Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit

a) Profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të studimit

Qëllimi themelor i programit është t'i aftësojë studentët për veprimtarinë cilësore me fëmijët e moshës 0-3 vjeç. Studentët, përmes këtij programi, do të përgatiten në aspektin teknik



dhe praktik në fushën e edukimit dhe zhvillimit të hershëm të fëmijës. Ata do të aftësohen të komunikojnë me fëmijët dhe të rriturit, duke përcaktuar në mënyrë të drejtë objektivat për të zhvilluar dhe analizuar në mënyrë kritike veprimtarinë e tyre. Lëndët e përzgjedhura në programin e studimeve për edukimin dhe zhvillimin e hershëm, u ofrojnë mundësi studentëve që të përvetësojnë njohuri profesionale dhe praktike në shumë fusha të veprimtarisë edukative në fëmijërinë e hershme.

Për të arritur këto kompetenca profesionale kursi 2-vjeçar artikulon ofertën formuese në kompetenca teorikë thelbësore (të natyrës pedagogjike, psiko-sociale, antropologjike), për të kuptuarit e kushteve të fëmijërisë së hershme në shoqërinë bashkëkohore dhe modelet kryesore të ndërhyrjes pedagogjike dhe didaktike ekzistuese si dhe kompetencave praktike funksionale për zhvillimin e proceseve edukuese në kontekstet e përmendura.

Vëmendje të veçantë u jepet kompetencave të natyrës didaktike, për t'u dhënë mundësi edukatorëve të përdorin instrumentet e përshtatshme në projektimin dhe programimin edukativ, i cili lidhet me kompetencat të cilat nevojiten për analizën e nevojave edukative individuale dhe në grup të fëmijëve. Ky kurs synon të transmetojë kompetenca të cilat do t'u shërbejnë edukatoreve të ndërtojnë marrëdhënie dhe të dialogojnë me realitete të ndryshme familjare, duke ushtruar funksione direkt dhe indirekt në mbështetjen e prindërimit.

Përgjatë formimit që do të ofrohet nëpërmjet këtij kursi, peshë të veçantë u është kushtuar kompetencave që lidhen me praktikën e cila do të zhvillohet në formën e laboratorëve formuese profesionale në struktura të ndryshme që ofrojnë shërbime për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme që veprojnë në nivel kombëtar dhe/ose në mjediset e universitetit në formë simulimesh, projektimesh etj. Kjo formë e praktikës është parashikuar të zhvillohet në semestrin e dytë dhe të katërt të kursit.

Në përfundim të këtij programi, jepet diploma profesionale **“EDUKATORE PËR ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN E FËMIJËRISË SË HERSHME” (0-3 vjeç).**

Kreditet e fituara në këtë program studimi mund të transferohen nga studentët në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor deri në masën 60%.

Lëndët dhe modulet e këtij programi studimi janë hartuar mbi bazën e arritjeve bashkëkohore të Universitetit të Janinës, Universiteti i Maqedonisë Perëndimore Kozani Greqi, Universitetit “Hasan Prishtina”, Kosovë dhe përvojës së institucioneve të tjera që merren me foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme.

b) Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor.



Programi i studimit për përgatitjen e edukatoreve për fëmijërinë e hershme synon:

1. Formimin e kompetencave shkencore, pedagogjike, metodologjike, didaktike, psikologjike, sociologjike, antropologjike, historiko-filozofike, të komunikimit dhe përdorimit të teknologjive të informacionit, të cilat do të përmbushin objektivat e arsimit në shoqërinë e dijes për punësim dhe për ruajtjen e vlerave kulturore e kombëtare.
2. Pajisjen e studentëve me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për arritjen e standardeve të larta në shërbimet për fëmijërinë e hershme, duke zbatuar teoritë dhe praktikën e të nxënies dhe të kujdesjes, në lidhje me karakteristikat e grupmoshës, me veçoritë individuale të fëmijëve, me objektivat e arsimit gjithëpërfshirës, me përparësitë e arsimit në vendin tonë dhe rolin e edukatorit si profesionist në një kontekst social në ndryshim.
3. Aftësimin e studentëve për zgjidhjen e situatave problemore, për menaxhimin e mjedisit njohës, social, emocional dhe fizik të klasës.
4. Sigurimin e një konteksti akademik për diskutimin e çështjeve që lidhen me shkencat sociale dhe ato të edukimit, me synim, zhvillimin e perspektivës teorike të studentëve, zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale të tyre me teknologjinë e informacionit, duke përdorur metoda që sigurojnë një përvetësim aktiv të aftësive komunikuese, psiko-pedagogjike në lëndë të ndryshme, seminare dhe laboratorë.
5. Të aftësojnë studentët me shprehje teorike dhe praktike në aspektet e kujdesjes dhe ndërhyrjeve drejtuar fëmijëve me nevojë të veçanta, me njohuri, shprehje edhe vlera në gjuhën e huaj dhe në praktikën mësimore të vëzhguar ose simuluar, në strukturat që ofrojnë shërbime për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme dhe/ose në mjediset e universitetit.
6. Diploma profesionale **“EDUKATORE PËR ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN E FËMIJËRISË SË HERSHME”** mundëson hapin e parë drejt profesionit të edukatorit për grupmoshat 0-3 vjeç, për të punuar si në çerdhet shtetërore ashtu edhe në ato private, si dhe në të gjitha strukturat që ofrojnë shërbime për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme, duke iu përgjigjur sa më mirë tregut të punës. Gjithashtu mundësohet vazhdimi i studimeve në nivelin e parë Bachelor.

c) Mundësitë për punësim

Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional pas arsimit të mesëm **“EDUKATORE PËR ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN E FËMIJËRISË SË HERSHME”** do t’u ofrojë kompetenca profesionale individëve që mendojnë të punojnë si edukatore në institucionet për këtë moshë siç janë çerdhet, strukturat e ndryshme që ofrojnë shërbime për



foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme, shërbime në mbështetje të prindërve (qendrat për familjet apo kënde loje etj.).

III. STRUKTURA AKADEMIKE PËRGJEGJËSE DHE STRUKTURAT E TJERA BASHKËPUNUESE

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë
Struktura të tjera bashkëpunuese Brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë	Departamenti Gjuhës dhe i Letërsisë, Departamenti i Historisë, Departamenti i Gjuhës Angleze Në F E SH SH Departamenti Matematikë-Informatikë Departamenti Biologji-Kimi Departamenti i Infermierisë dhe Fizikës Në F Sh N
Institucione të huaja të arsimit të lartë	Universiteti i Janinës, Greqi Universiteti i Maqedonisë Perëndimore Universiteti Kozan, Greqi
Subjekte të tjera publike apo private	Bashkia Gjirokastrë DAR Gjirokastrë Prefekti i Qarkut Gjirokastrë Zyrën Rajonale të punësimit



IV. KUADRI I PËRGJITHSHËM FORMUES I PROGRAMIT TË STUDIMIT

STRUKTURA E PLANIT MËSIMOR PËR VITIN AKADEMIK

Kategoria	Tipi i veprimtarisë dhe simboli përcaktues	Fushat disiplinore apo veprimtari të tjera formuese	Kredite	Totali i kredite ve
Simboli: A 5-10%	LËNDË BAZË- Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	Psikologji e përgjithshme dhe e fëmijërisë së hershme	12	12
Simboli: B 40%	LËNDË KARAKTERIZUESE Përgatitje për disiplinën shkencore	Pedagogjia e fëmijërisë së hershme	7	48
		Gjithëpërfshirja në edukimin e hershëm	7	
		Modele të ndërmjetësimit didaktik	7	
		Historia e teorive për foshnjërinë	7	
		Formimi gjuhësor dhe komunikimi	7	
		Antropologji Kulturore	6	
		Letërsi për foshnjërinë	7	
Simboli: C 20-30%	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INT EGRUESE- nëndisiplina, profile dhe grup-lënësh me zgjedhje që lidhen me disiplinat karakterizuese.	Sociologji e organizatave dhe e shërbimeve	6	36
		Sociologji e përgjithëshme	6	
		Edukimi muzikor	6	
		Formimi trupor dhe metodologji e lojës	6	
		Përkujdesjet mjekësore në fëmijërinë e hershme	6	
		Lëndë me zgjedhje	6	
	Disiplina me zgjedhje			



		DZ. 1. Vizatimi dhe ngjyrat në fëmijërinë e hershme		
		DZ. 2. Psikologji sociale		
Simboli: D 10%	LËNDË PLOTËSUESE- gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.	Laborator informatike	4	12
		Praktik profesionale	8	
Simboli: E 10%	Provimi i Diplomës/Teza e diplomës	Diplomimi	12	12
Totali				120

PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT

Doc. Dr. Mimoza ÇARKA



V. TË DHËNA PËR PERSONELIN AKADEMIK QË MBULON DISIPLINAT E MËSIPËRME

Nr	Personeli akademik	Titulli apo grada shkencore	Institucioni	Dep./Qendra Njësia kryesore	Lëndët/Modul et përkatëse	Me kohë të plotë ose të pjesshme
1.	Mimoza ÇARKA	Doc.Dr	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	1. Psikologji e fëmijërisë së hershme 2. Gjithëpërfshirja në edukimin e hershëm	Me kohë të plotë
2.	Bekdash MEMA	Prof.dr.	UGJ Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Historisë	Antropologji kulturore	Me kohë të plotë
3.	Gëzim SALA	Prof.dr	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Historisë	Sociologji e organizatave dhe e shërbimeve	Me kohë të plotë
4.	Jaho CANAJ Kozeta SALA	Prof.Asoc. dr Prof.Asoc. dr	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Historisë	Sociologji e përgjithshme	Me kohë të plotë
5.	Ilir BOZGO Aida Sotiri	Prof.Asoc. dr Msc.	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	2. Formimi gjuhësor dhe komunikimi 3. Psikologji sociale	Me kohë të plotë
6.	Loreta MAMANI	Dr.	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	Pedagogji e fëmijërisë së hershme	Me kohë të plotë



7.	Margarita HIDO	DOC	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	Modele të ndërmjetësimit didaktik	Me kohë të plotë
8.	Zhuljeta LILO	Dr.	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	1. Histori e teorive për foshnjërinë 2. Praktikë profesionale	Me kohë të plotë
9.	Harallamb MARGARI TI	DOC	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	Vizatimi dhe ngjyrat në fëmijërinë e hershme	Me kohë të plotë
10.	Gjergji SPIRI	DOC	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	Edukim muzikor	Me kohë të plotë
11.	Elvira Barka	MSC	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	Formimi trupor dhe metodologjia e lojës	Me kohë të plotë
13.	Zamira VLLAHO	Doc.Dr.	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Infermierisë	Përkujdesjet mjekësore në fëmijërinë e hershme	Me kohë të plotë
14.	Dhori TERPO	Dr.	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Matematikës-Informatikës dhe Fizikës	Laborator informatike	Me kohë të plotë
15.	Merita SHEHU	Prof.Asoc. dr	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Letërsisë	Letërsi për fëmijë	Me kohë të plotë
16.	Valbona Caushi	MSC	Universiteti "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë	Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	Psikologji e fëmijërisë së hershme	Me kohë të plotë



**VI. PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT 2-VJEÇAR ME
KARAKTER PROFESIONAL
“EDUKIM PËR FOSHNJËRINË DHE FËMIJËRINË E HERSHME” VITI
AKADEMIK 2018-2020**

VITI I PARË 2018-2019

Ndërtimi i Planit Mësimor (Sem. I + II 36 javë)

A. STRUKTURA

Format e veprimtarive mësimore	Semestri I Javët	Semestri II Javët	Nr. Prov./ Firma Sem I	Nr. Prov./ Firma Sem II	Gjithsej
Mësim	15 javë	15 javë			
Provime	3 javë	3 javë	5 P	4P	
Gjithsej	18 javë	18 javë	5P	4P	9 P

Nr	Lëndët	Semestri		Orë në javë	Ngarkesa L/S/P	Simboli	Orë në auditor	Orë jashtë auditorit	Orë gjithsej	Forma e vlerësimit	
		1	2							Provim	Kreditet
	Antropologji kulturore		X	4	2L/2S	B	60	90	150	P 1	6
	Pedagogji e fëmijërisë së hershme	X		5	2L/3S	B	75	100	175	P 2	7
	Psikologji e përgjithshme dhe e fëmijërisë së hershme	X	X	4	2L/2S	A	120	180	300	P 3	12
	Sociologji e përgjithshme	X		4	2L/2S	C	60	90	150	P 4	6
	Gjithëpërfshirja në edukimin e hershëm	X		5	2L/3S	B	75	100	175	P 5	7
	Formimi trupor dhe metodologjia e lojës		X	4	2L/2S	C	60	90	150	P 6	6
	Sociologjia e organizatave dhe shërbimeve		X	4	2L/2S	C	60	90	150	P 7	6
	Përkujdesjet		X	4	2L/2S	C	60	90	150	P 8	6



	mjekësore në fëmijërinë e hershme										
	Laborator informatike	X		3	1L/2S	D	45	55	100	P 9	4
	Shuma e krediteve dhe orëve	5	4	37	17/20		615	885	1500	9 P	60

VITI II DYTË 2019-2020

Ndërtimi i Planit Mësimor (Sem. III + IV 33 javë)

A. STRUKTURA

Format e veprimtarive mësimore	Semestri III Javët	Semestri IV Javët	Nr. Prov./Firm. Sem III	Nr. Prov./Firm. Sem IV	Gjithsej
Mësim	15 javë	15javë			
Provime	3 javë		6P		
Praktikë Ped.		10 javë		1 p	
Teza e Diplomës		5 javë		1P	
Gjithsej	18 javë	15 javë	6	2	8

Nr	Lëndët	Semestri		Orë në javë	Ngarkesa	Simboli	Orë në auditor	Orë jashtë auditorit	Orë gjithsej	Forma e vlerësimit	Kreditet
		3	4							Provim	
1	Formimi gjuhësor dhe komunikimi	X		5	2L/3S	B	75	100	175	P 1	7
2	Modele të ndërmjetësimit didaktik	X		5	2L/3S	B	75	100	175	P 2	7
3	Edukimi muzikor	X		4	2L/2S	C	60	90	150	P 3	6
4	Vizatimi dhe ngjyrat në fëmijërinë e hershme (Z)	X		4	2L/2S	C	60	90	150	P 4	6
	Psikologji sociale (Z)										
5	Histori e teorive për foshnjërinë	X		5	2L/3S	B	75	100	175	P 5	7



6	Letërsi për foshnjërinë	X		5	2L/3S	B	75	100	175	P 6	7
7	Praktik profesionale		X			D		200	200	P 7	8
8	Mikrotezë/Provimi formimi		X			E		300	300	P 8	12
	Shuma e krediteve dhe orëve	6	2	28	12/16		420	1080	1500		60

Përgjegjësi i departamentit

Doc.Dr Mimoza ÇARKA

DEKANI

Prof.dr Gëzim SALA



VII. INFRASTRUKTURA NË DISPOZICION TË PROGRAMIT (INFORMACION LIDHUR ME: AUDITORËT, LABORATORËT E DUHUR, BIBLIOTEKËN, MJETET KOMPJUTERIKE SISTEMET IT, ETJ)

Sallat e leksioneve dhe të seminareve (kapaciteti):

Laboratorët:

Biblioteka:

Sekretaria Mësimore:

Departamenti:

TABELË STATISTIKORE NË LIDHJE ME SHPËRNDARJEN E FACILITETEVE TEKNOLOGJIKE PËR UNIVERSITETIN NË TËRËSINË E TIJ STRUKTURE

Ref.	Teknologji kompjuterike	Njësia (në copë)
1.	Numri i PC për stafin akademik	65
2.	Numri i printerëve për stafin akademik	30
3.	Numri i PC për administratën	5
4.	Numri i printerëve për administratën	4
5.	Numri i PC për bibliotekën	4
6.	Nr i PC për studentët (salla e kompjuterëve)	101
7.	Numri i printerëve për studentë	10
8.	Numri i PC për auditor mësimor	12
9.	Numri i projektorëve për auditor mësimor	22
10.	Numri i skanerëve	4
11.	Numri i fotokopjeve	7

Tabela përmbledhëse e pajisjeve IT

Ref.	Teknologji kompjuterike	Totali (në copë)
1.	PC	166
2.	Kompjuterat portative	12
2.	Printerat	34



3.	Skanera	4
4.	Fotokopje	7
5.	Projektorë	22

Biblioteka

Libra dhe tituj		Sipas klasifikimit lëndor				Libri shqip dhe i huaj		Blerjet dhe dhurime (tituj)	
tituj	libra	Gjuhë-letërsi	Histori-gjeografi	Psikologji didaktikë	Gjuhë e huaj	shqip	i huaj	Blerje	Dhurime
8500	59500	4000	840	410	100	55.000	4500	300	4200

Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore është organizuar dhe funksionon në e Universitetit "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë në mesin e godinës A dhe godinës B

E paraqitur në mënyrë strukturore godina përbëhet nga 883 vende për mësim të shpërndara në:

- 1 auditor me 200 vende
- 1 sallë konferencash me kapacitet 90 vende e pajisur me simulant, laptop dhe projektor
- 7 salla auditorësh me kapacitet prej 50-100 vendesh, të gjitha të pajisura me projektor
- 15 salla seminaresh me kapacitet prej 40-60 vendesh, të cilat janë të pajisura me projektor.
- 1 Qendër e Zhvillimit të Karrierës me kapacitet 30 - 40 e pajisur me 2 videoprojektorë, 1 laptop, 20 kompjuterë, 4 printer, 2 fotokopje, Tv, bibliotekë të specializuar në fushën e didaktikës dhe metodologjisë së mësimdhënies.
- 1 mediatekë të Gjuhëve të Huaja të pajisur me projektor, magnetofon, sistem të instaluar fonie dhe përkthimi
- 1 laborator të gjuhëve të huaja me kapacitet 54 vende, të pajisur me projektor dhe sistem të instaluar fonie
- 4 laborator të informatikës me kapacitet 25 – 50 vende të pajisur me projektor dhe 20-50 kompjuterë
- 1 zyre sekretarie e pajisur me 2 sete kompjuterike, 1 printer, si edhe 1 fotokopje
- 8 zyra dhe ambiente pune për stafin akademik dhe ndihmës-mësimore pajisur me bazën materiale të domosdoshme për personelin akademik



3 ambiente të shërbimit higjeniko-sanitar për studentët dhe 2 për stafin akademik dhe ndihmësmësitor.

1 bibliotekë qendrore e Universitetit.

Shpërndarja e faciliteteve, mjediseve, si dhe kapacitetet e tyre për realizimin e suksesshëm të procesit akademik, paraqiten si më poshtë :

Salla e leksioneve : 8 auditorë, në të cilët zhvillojnë procesin akademik 1749 studentë në të gjitha ciklet e studimit.

Salla e Seminareve: Numri i tyre është 9 me një kapacitet prej 40-80 studentësh

Laboratorët: Laboratori i Gjuhëve të Huaja.

Biblioteka: E cila përmban strukturën e nevojshme për të vendosur një numër prej 68.500 librash.

Sekretaria Mësimore: Është njësia pranë së cilës zhvillohet procesi administrativ brenda Fakultetit, e cila është e pajisur me paisjet e duhura për zhvillimin normal të punës administrative, dhe konkretisht 2 sete Kompjuterash, 1 printer dhe 1 printer – fotokopje. Pranë sekretarisë mbahet edhe një pjesë e Arkivit, si edhe regjistrat bazë të shkollës.

Departamentet: Në total janë 7 salla departamentesh të pajisura me të gjithë mjetet e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të tyre si sete kompjuterike, printer SharePoint etj.

Zyra e Dekanit: -1 - në të cilën Dekani kryen të gjithë veprimtarinë e tij administrative, të pajisura me 1 set Kompjuter, 2 printera, raftë arkivimi, bibliotekë personale, TV.etj. Në një zyrë të veçantë të dekanit punon asistenti e tij, i cila shfrytëzon 1 set Kompjuter, 1 printer, 1 fotokopje, raftë arkivimi.

Një pasqyrë përmbledhëse e shpërndarjes së sipërfaqes totale sipas mjediseve funksionale përkatëse:

Ambientet e leksioneve dhe seminareve kanë siguruar një hapësirë të madhe për studentët. Në ambientet e leksioneve studion një numër maksimal prej 100 studentësh (200 studentë në amfiteatër), ndërsa për një sallë seminaresh është përcaktuar një numër maksimal prej 60 studentësh. Pra, parë në këndvështrimin praktik, përmes këtij kapaciteti, studentit i krijohet një mjedis komod dhe i mjaftueshëm për ndjekjen e procesit të mësimdhënies.

Studentët gëzojnë akses të plotë me internetin, cilësia e të cilit është e lartë.

Tabela e njësive përbërëse të një seti të teknologjisë së informacionit për çdo auditor mësimor projektor dhe kompjuter laptop (personal për pjesën më të madhe të stafit akademik). Kjo infrastrukturë e teknologjisë kompjuterike e përmendur më sipër ndodhet në auditorët mësimorë dhe është drejtpërdrejt në funksion të çdo ore mësimore. Megjithatë përveç saj ekziston dhe një infrastrukturë kompjuterike mbështetëse, një pjesë e së cilës është në shërbim të studentëve (e cila ndihmon studentët në përgatitjen e tyre gjatë procesit të të mësuarit jashtë orëve mësimore), të stafit akademik dhe të administratës.



VIII. KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAM.

Numri i propozuar i studentëve që do të pranohen në program	60
Numri minimal i studentëve për hapjen e programit	10

IX. TARIFAT E SHKOLLIMIT

Tarifat e shkollimit	40 000	Kostoja e shkollimit	43 900
----------------------	--------	----------------------	--------

X. Financimi i programit

Si burim financimi i këtij programi studimi do të jetë buxheti i universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër dhe të ardhurat që do të gjenerohen nga tarifat e shkollimit.



XI. LISTA E SYLLABUSEVE TË LËNDËVE

1. ANTROPOLOGJI KULTURORE
2. HISTORI E TEORIVE PËR FOSHNJËRINË
3. PEDAGOGJI E FËMIJËRISË SË HERSHME
4. PSIKOLOGJI E PËRGJITHSHME DHEPSIKOLOGJI E FËMIJËRISË SË HERSHME
5. SOCIOLOGJI E PËRGJITHSHME
6. MODELE TË NDËRMJETËSIMIT DIDAKTIK
7. FORMIMI GJUHËSOR DHE KOMUNIKIMI
8. SOCIOLOGJI E ORGANIZATAVE DHE E SHËRBIMEVE
9. VIZATIMI DHE NGJYRAT NË FËMIJËRINË E HERSHME
10. PSIKOLOGJI SOCIALE
11. EDUKIMI MUZIKOR
12. LETËRSI PËR FOSHNJËRINË
13. GJITHPËRFSHIRJA NË EDUKIMIN E HERSHME
14. PËRKUJDESJET MJEKSORE NË FËMIJËRINË E HERSHM
15. FORMIMI TRUPOR DHE METODOLOGJIA E LOJËS
16. LABORATOR INFORMATIKE
17. PRAKTIKE PROFESIONALE

